

Pavarësia në korrik, problem është Kina jo Rusia

120 ditë do të jetë periudha e tranzicionit

EPOKA E RE: *Z. Pacolli brenda kësaj jave pritet që kryenegociatori për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, t'ua prezantojë palëve planin e tij, të cilin ju e keni parë. Si do ta komentoni këtë pako dhe çfarë përmban ajo brenda saj?*

Pacolli: Nëse nuk ndërron asgjë, Ahtisari më datë 2 shkurt do ta prezantojë pakon e tij në Prishtinë. Janë dy volume apo pjesë: pjesa politike dhe ajo teknike, me disa shtojca apo të ashtuquajtura anekse dhe Ahtisari nuk e përmend pavarësinë, siç kanë thënë. Për mua është shumë e logjikshme dhe asnjëherë nuk e kam pritur që Ahtisari ta përmend në dokumentin e tij pavarësinë, për arsye se ai nuk ka kurrfarë autorizimi ta përmend pavarësinë. Ai nuk është personi që do ta definojë një Kosovë të pavarur apo sovranitetin serb mbi Kosovën. Puna e Ahtisarit ka qenë një vazhdim i punës së Kai Aides dhe ai ka përshkruar situatën në terren, ka dëgjuar opinionin e Serbisë, ka verifikuar dokumentacionin shtetëror që Serbia posedon për Kosovën në ato fusha që atij i ka interesuar, është kthyer në Kosovë dhe në bazë të gjitha informatave që i ka marrë, si dokumentaret, opinionet e ndryshme, situatën në terren, ka përpiluar dokumentin në të cilin përshkruan mënyrën se si do të funksionojë Kosova në të ardhmen. Në bazë të këtij përshkrimi Kombet e Bashkuara, pikërisht Këshilli i Sigurimit, do ta marrë vendim dhe me një përqindje shumë të madhe do të propozojë pavarësinë e Kosovës, e cila do të kalojë me vota të anëtarëve të përhershëm të KS-së dhe pritet që ajo të votohet. Janë tri vota të sigurta, më duket se do të ketë një abstenim nga Rusia, mirëpo Kina është tani e padefinuar.

EPOKA E RE: *Ju përmendët Raportin e Kai Aides, i cili përshkruan brenda tij se duhet të ketë një status të ardhshëm për Kosovën. A është edhe pakoja e Ahtisarit me këtë përmbajtje apo në këtë vazhde të definimit të statusit të Kosovës?*

Pacolli: Është vazhdim i punës. Kai Aide ka bërë një raport vetëm për përmbushjen e standardeve në Kosovë. Ndërsa, Ahtisari në bazë të Raportit të Aides ka trasuar rrugën apo mënyrën se si Kosova do të ecë përpara, me shumë kujdes, sidomos në raportet ndërnacionale, ndërnjerëzore dhe ndërfaqetare në Kosovë. Ai kujdesin më të madh ia ka kushtuar bashkëjetesës në mes të komunitetit serb dhe shqiptar. Këtu do të ketë ngatërime dhe për këtë është paraparë një kohë prej 120 ditëve duke filluar nga data 2 shkurt. Pra, 120 ditë do të jetë periudha e tranzicionit dhe në këtë kohë do të ketë takime mes palëve, do të thotë mes Prishtinës dhe Beogradit. Do të sqarohen shumë gjëra dhe do të ketë shumë pyetje. Këtu qeveria vendore do të jetë më pak e plotfuqishme në këtë periudhë, jo që do t'i merren të drejtat e qeverisjes vendore, mirëpo ajo nuk do të ketë fuqi që ta ndërrojë situatën, por ajo duhet ta pranojë në atë mënyrë. Mund të pyes dhe të dëgjojë, të bëjë sqarime, mirëpo frikohem se në këtë pako nuk do të mund të ndërrohet diçka vetëm nga njëra palë, do të ketë ndryshime vetëm nëse të dyja palët janë dakord. Nëse njëra palë nuk është dakord nuk mund të ndërrohet konkluzë që e ka paraqitur në dokumentin e tij Ahtisari.

EPOKA E RE: *Mund të kemi në një rast të tillë një Kosovë të "papagëzuar" që do t'u jepte mundësi të gjitha palëve ta "pagëzojnë" sipas dëshirës së tyre?*

Pacolli: Kosova nuk mund të jetë anonime pas gjysmës së dytë të prillit. Deri atëherë do të jetë e "papagëzuar", nuk do ta ketë një emër. Do të jetë një periudhë e tranzicionit. Do të ketë takime, do të qeveriset Kosova nga vendorët si deri më tani, mirëpo në mënyrë të limituar. Do të jetë e limituar edhe në deklaratat e tyre ndaj publikut, do të ketë një censurë për masmediat dhe çdo gjë do të jetë shumë e kontrolluar nga komuniteti ndërkombëtar.

Është obligim moral i Ruisë që ta përkrahë Beogradin, por në momentin e fundit do të abstenojë

EPOKA E RE: *Ju thoni se zgjidhja do të shkojë në KS të OKB-së dhe në anën tjetër, keni thënë se Rusia nuk do ta përdorë VETO-n. Mbi çfarë argumentesh Rusia nuk do ta përdorë VETO-n?*

Pacolli: Jam i bindur se Rusia nuk do ta përdorë veton. Ju e dini se unë kam lobuar në SHBA menjëherë pas ngjarjeve të viti 2001, duke parë të arsyeshme se çdo gjë është harruar për Kosovën në atë kohë. Normalisht kanë qenë probleme shumë të mëdha si Afganistani, më vonë Iraku, sulmet terroriste në Spanjë, Londër dhe tragjeditë me ushtarët amerikanë dhe shumë pak vend ka pasur të për Kosovën. Unë e kam parë të arsyeshme që të krijohet një grup i njerëzve lobit nga administratat e përparshme, duke filluar nga ish-Presidentët Karter, Regan e Bushi i vjetër dhe të gjithë kanë qenë njerëz me një "background" të fortë politik, të cilët kanë lobuar për Kosovën, që emri dhe problemi i Kosovës të mos harrohet dhe ajo punë është kryer me një efikasitet shumë të madh. Një gjë e tillë është dashur të bëhet edhe në Rusi. Ndoshta ka qenë e pakuptueshme prej popullit në Kosovë, prej opinionit publik, sidomos nga masmediat dhe gazetarët, kur kam thënë se duhet të punohet me Veriun, Jugun, Lindjen dhe Perëndimin. Rusia, duam apo nuk duam, është anëtar i përhershëm i KS të OKB-së, është një fuqi reale sot në botë dhe është dashur të punohet. Unë e di prej diplomacisë, prej leximit, prej eksperiencës, se nëse armikun nuk mund ta luftosh, tento të bëhesh "komplic" i tij, ose tento ta fitosh si "komplic" dhe është dashur të punohet me ta, pse jo të bëhet lobim atje. Këtë nuk e ka përkrahur opinionin publik në Kosovë, nuk e kanë përkrahur qeveritarët, mirëpo unë e kam parë të arsyeshme që të lobohet në Rusi. Unë po bëj të njëjtën gjë ende të SHBA dhe Bruksel, të njëjtën gjë edhe në Rusi. Dhe besoj se kjo do të ketë sukses. Rusia do të jetë shumë konstruktive në momentin e fundit, edhe pse Rusia deri në momentin e fundit do të angazhohet shumë që Serbia sa më tepër të përfitojë prej kësaj situatë. Është e logjikshme, sepse janë të afërt, kanë një fe, kanë një prejardhje, është shumë



logjike, askush nuk duhet ta marrë si tragjike këtë. Është e njëjta gjë, sikur neve që na përkrahë Shqipëria, është obligim moral i Shqipërisë, edhe në këtë rast është obligim moral i Rusisë që ta përkrah Beogradin. Mirëpo, në momentin e fundit Rusia do të abstenojë.

EPOKA E RE: *Në vazhden e lobimit Qeveria e Kosovës vitin e kaluar kishte një takim me zyrtarë rusë dhe ju keni deklaruar se nuk ju kanë kontaktuar dhe se ajo ka dështuar. Vërtet nuk ka ndikuar ajo vizitë në përmirësimin e pozitës tonë në Rusi?*

Pacolli: Vizita ka qenë një komprometim për neve. Si njeri i parë i një qeverie të një shteti në gjithë botën ai tenton dhe normalisht është dashur të takohet me homologun e tij. Sot kemi shtete të vogla dhe të mëdha dhe dikush nga Paraguai apo Xhamajka shkon në cilësinë e kryeministrit dhe takohet me Bushin, ashtu e do protokollin. Dhe shkuarja e kryeministrit në Rusi pa asnjë përgatitje, për mua ka qenë një befasi. Një javë para se të bëhet kjo vizitë, kam thënë se nuk duhet të bëhet dhe kam tentuar që ajo të mos bëhet. Ata kanë shkuar dhe e kam ditur se nuk do të kenë sukses, sepse janë takuar me njerëz pa kurrfarë kompetence. Kjo ishte sikur të kishte ardhur ndokush në shtëpi, të troket në derë dhe i zoti i shtëpisë t'u thotë fëmijëve 'hajt dilni të dera dhe shikoni çka po do ai'. Ashtu ka qenë kjo vizitë, mirëpo prapë se prapë, ajo ka pasur një jehonë, sepse kam arritur që në momentin e fundit ta bëjë atë çka është mundur të bëhet. Kam organizuar një konferencë me gazetarë shumë prestigjioze për kryeministrin në Rusi, në klubin më prestigjioz të masmediave në Rusi. Ka pasur efektin e vet pozitiv apo negativ është harruar dhe tani nuk është bërë asgjë, nuk është prishur puna dhe ky lobim do të ketë efektin e vetë.

Misioni i BE-së minimum pesë vite do të qëndrojë në Kosovë

EPOKA E RE: *Mundeni ju tani nga pozita që keni, që në minutat e fundit, të themi ashtu, t'i ndihmoni institucionet e Kosovës në raport me Rusinë, që kjo e fundit ta ndryshojë mendimin që tani ka?*

Pacolli: Gjithmonë për çdo gjë që ruhet në momentin e fundit ekziston rreziku që të mos ia dalë askush, të mos ketë sukses apo cilësi. Nuk jam prej momentit të fundit duke punuar, por unë që nga nëntori dhe kam edhe tre muaj kohë për të punuar dhe do të punoj. Unë besoj se do të bëhet një punë e mirë, aq efektive sa i nevojitet Kosovës që ta kalojë këtë situatë.

EPOKA E RE: *Ju thoni se Kina do të jetë problemi. Mendoni se asaj nuk i është kushtuar vëmendje e duhur dhe se është anashkalar gabimisht, dhe se tani ajo do të na shkaktojë shumë probleme në definimin e statusit të Kosovës në KS të OKB-së?*

Pacolli: Ne kemi vizituar shumë shtete, është dashur të punohet edhe me Kinën, nuk është menduar se Kina është anëtare e përhershme e KS të OKB-së, njësoj si Amerika dhe të tjerët. Unë shumë besoj se në këta tre muaj dikush do të merret edhe me Kinën. Kam pasur një takim të nivelit të lartë dhe është hapur tema e Kosovës. Ata kanë qenë skeptik dhe dyshoj se Kina mund të bëjë problem.

EPOKA E RE: *A mund të jetë Kosova si rast precedent në marrëdhëniet ndërkombëtare, siç paralajmëron Rusia dhe tani të njëjtën gjë mund ta bëjë edhe Kina, për shkak se kanë probleme të në rajonet e tyre?*

Pacolli: Ashtu është. Rusisë rasti i Kosovës apo pavarësia e saj drejtpërdrejt i konvenon, për arsye se nëse e merr si precedent, atëherë ajo do ta bëjë të njëjtën gjë me Isterin dhe Osetinë, mirëpo nuk e shoh se do të luhet kjo kartë apo biletë. Miqtë tanë në përfundim do të mundohen të bëjnë çdo gjë që Kosova të mos jetë precedentë, të mos ketë një paraqitje të tillë, mirëpo të deklarohet si një proces që ka filluar me qindra vjet më parë, menjëherë pas viteve të '13-ta të shekullit XX-të e deri më tani. Kështu komuniteti ndërkombëtar, sidomos miqtë dhe lobuesit e Kosovës, këtë proces e përshkruajnë si një proces që nuk ka filluar tani, nuk është si rezultat i bombardimeve të NATO-së, por si rezultat i jetës mes dy luftërave botërore, i Luftës së Dytë Botërore, i vuajtjeve dhe tragjediave që Kosova kishte pasur gjatë kësaj lufte në fund të viteve të '40-ta dhe '50-ta, emigrimit masiv për në Turqi etj. Ndodhitë e '68-tës, të '74-tës, të '81-it, '89-tës dhe sidomos periudha 1989/99 dhe eksodi që Millosheviqi e provokoi. Ky proces merret parasysh, ky proces duhet të përshkruhet si proces dhe jo si precedent. Një proces që ka një kohë shumë të gjatë që e rëndon situatën në terren, jo vetëm tani.

EPOKA E RE: *Kjo do të thotë se Serbisë pak ose hiq do t'i ndihmojë e Drejta Ndërkombëtare, mbi të cilën mbështetet se do të mund ta mbajë Kosovën nën sovranitetin e saj?*

Pacolli: Po dhe Jo! Mirëpo, nëse merret si precedent, atëherë ajo do ta ndihmojë sepse ekziston Rezoluta e OKB-së që mbron sovranitetin. Mirëpo, nëse futet varianti se ky është një proces që ka filluar para formimit të OKB-së, proces që nuk është kryer, atëherë ky pretendim i Serbisë do të dalë nga funksioni. Mu këtu është problemi tani. Nëse kemi fat që komuniteti ndërkombëtar e mbron këtë tezë se procesi i Kosovës ka filluar para Luftës së Parë Botërore dhe është bërë i padrejtë aneksimi i Kosovës nga Serbia, atëherë ka shanse të mëdha dhe duket ashtu sot se ky proces kështu do të paraqitet dhe kështu do të trajtohet nga KS i OKB-së.

EPOKA E RE: *Pakaja e Ahtisarit, po ashtu parasheh transformimin e UNMIK-ut në një mision të BE-së. Si e shihni ju rolin dhe fuqinë që do ta ketë ky mision në Kosovë?*

Pacolli: Është e njëjta gjë si UNMIK-u, vetëm se ne do të kemi kualitet dhe cilësi të ndërkombëtarëve. Derisa UNMIK-u ka mbledhur njerëz nga shumë vende të botës, pa e verifikuar shumë kualitetin, eksperiencën e tyre, sepse ne kemi parë njerëz që asnjëherë në jetën e tyre nuk kanë qenë inspektorë të një subjekti që ata e kanë aplikuar në Kosovë. Këtu kemi pasur të bëjmë

më njerëz të çuditshëm, edhe pse Kosova ka përfituar nga prezenca globale në Kosovë. Me ardhjen e BE-së ne do të kemi cilësi shumë të mirë në njerëz, profesionistë që do t'u ndihmojnë kosovarëve ta formojnë dhe zhvillojnë shtetin e tyre. Një dallim tjetër i arsyeshëm është se OKB-ja është larg, ne jemi në derë të Evropës dhe një e tretë është se, me Evropën do t'i mësojmë gjërat dhe do t'i respektojmë ato standarde "vigjente" në Evropë. Po ashtu, do të jemi më të përgatitur për një hyrje të rajonit në BE, pasi që nuk ka më hyrje një nga një. Evropa do ta hapë derën dhe i gjithë rajoni do të hyjë njëherazi.

EPOKA E RE: *Po si do t'u përgjigjeni zërave që thonë se ky mision do të jetë edhe më i rreptë se ai në Bosnjë?*

Pacolli: Ne duhet ta presim ashtu. Është i vështirë, i vështirë si ta kuptosh. Nëse është i rreptë do të ketë cilësi më të mëdha, pasi që ne nuk jemi të përgatitur për udhëheqjen e një shteti. Ne nuk kemi struktura për udhëheqjen e një shteti, ne nuk jemi të vetëdijshëm se nuk jemi të përgatitur. Me këtë korrupsion, këtë padrejtësi që jemi duke ia bërë popullit tonë, me këtë mënyrë të ekonomizimit, politikës, nuk jemi të përgatitur. Ne jemi diletantë në këtë drejtim dhe kemi nevojë edhe shumë për ndihmë ndërkombëtare dhe ajo do të jetë. Nuk kam vendosur unë si Behxhet Pacolli, mirëpo unë e shoh të arsyeshme prezencën e tyre. Sa më rigide që të jetë ajo, do të thotë se tregon se barometri ka rënë ulët, sa i përket vlerësimit të aftësive të qeverisë vendore.

EPOKA E RE: *Sa e gjatë mendoni se do të jetë kjo periudhë e administrimit të ri ndërkombëtar?*

Pacolli: Unë besoj se së paku edhe pesë vjet. Mund të flasim pas pesë vjetëve, ndoshta që do të lirohemi dhe edhe më tutje do të kemi mbikëqyrës në një numër më të reduktuar. Mirëpo, në pesë vjetët e ardhshme jam i bindur se do të ballafaqohemi me ndërkombëtarët. Për mua është një gjë pozitive. Ndërkombëtarët mund vetëm dije të sjellin, e sidomos cilësia evropiane është shumë e nevojshme për Kosovën. Shoqëria kosovare me ardhjen e ndërkombëtarëve ka përfituar shumë, jo materialisht sepse asgjë materialisht nuk ka përfituar, por në fushat tjera po, si në njerëz, kompjuterë, teknologji, muzikë, pra ka pësuar një hapje ndaj botës dhe kemi një rini shumë të përgatitur. Ndërkombëtarët kanë qenë ata të cilët kanë paqësuar dy partitë më të mëdha në pushtet. Ju e dini se mbi tre muaj nuk kemi mundur ta zgjedhim kryetarin në Kosovë dhe po të mos kishin qenë ndërkombëtarët çka do kishte ndodhur këtu. Një luftë civile ndoshta?!

Unë i kam punët mirë dhe jam president i vetvetes... kam ardhur këtu t'ia paguaj borxhin Kosovës

EPOKA E RE: *Ju doni të thoni se prezenca e tanishme dhe e ardhshme në Kosovë është rezultat i paaftësisë së vendorëve për të qeverisur me vendin, për të cilën gjë edhe i kritikoni?*

Pacolli: Prezenca ndërkombëtare këtu është si pasojë e paaftësisë së vendorëve. Jo që nuk janë të aftë, dreqësitë i dinë shumë mirë, por nuk kanë prirje, nuk kanë vullnet të bëjnë diçka. I marrin gjërat me lehtësi, shkel e shko, nuk janë serioz në ekzekutimin e detyrave të tyre. Kanë papërgjegjësi dhe e gjithë kjo e bën për t'u qeshur me qeverinë tonë. Jo se nuk i dinë, sepse gjërat nëse nuk i dinë i mësojnë. Nuk ka njeri që i di të gjitha gjërat, por nëse nuk i di ti shkon i shfleton dhe i mëson ato, mirëpo nëse ti nuk ke vullnet dhe konstruktivitet, ti je i destinuar në mospushtet. Nëse ke vullnetin dhe konstruktivitetin ke për t'ia dalë asaj.

EPOKA E RE: *Është paralajmëruar se nëse Kosova e shpallë pavarësinë, serbët, përkatësisht pjesa veriore e Kosovës, do të mund të shpallin autonomi. A ekziston realisht ky rrezik tani?*

Pacolli: Jo, jo, nuk do të ndodhë kjo. Kosova nuk do ta shpallë vetë pavarësinë, nuk do të ndodhë ajo, nën një. Kosova kurrë nuk do të ndahet. Brenda Kosovës mund të ndodhin gjëra që nuk do t'u pëlqejnë shqiptarëve, nuk u pëlqejnë serbëve, nuk i pëlqejnë ndonjë partie politike, mund të ndodhë. Mirëpo, nuk do të ndahet Kosova, nuk do të ndahet Mitrovica e Veriut dhe Kosova nuk do t'i bashkohet askujt. Si e tillë do të hyjë në BE.

EPOKA E RE: *Vazhdoni ta kritikoni qeverinë për gjendjen e tanishme, vërtet qeveria e ka sjellë këtë gjendje dhe kush do të duhej realisht ta mbajë përgjegjësin për këtë që kemi sot?*

Pacolli: Mosserioziteti në punën e tyre. Nuk janë marrë gjërat me seriozitet, normalisht jo krejt. Kemi njerëz shumë të sinqertë, seriozë, njerëz punëtorë dhe këta janë shumica. Si është konsoliduar qeveria e Kosovës është një gjë që unë ende sot nuk e kuptoj. Nuk janë marrë parasysh profesionet, nuk janë marrë parasysh meritat e njerëzve, nuk janë marrë parasysh rezultatet e njerëzve. Është formuar një qeveri pa kuptim. Prandaj, edhe nuk ka rezultat kjo qeveri. Prandaj, kemi edhe sot gjenerim të varfërisë, papunësisë dhe gjendja sociale është çdo ditë e më e keqe.

EPOKA E RE: *Kishte shumë deklarata për mundësinë e krijimit të një qeverie gjithëpërfshirëse në Kosovë në prag të statusit. A do të pranoni ju që të jeni pjesë e kësaj qeverie, nëse do të ndodhë diçka e tillë?*

Pacolli: Vetëm nëse do të ishte shumë e qartë dhe e sigurt se në atë qeveri punojnë profesionistët, njerëzit që e duan punën, njerëzit e sinqertë, njerëzit transparentë. Ndryshe, nuk kisha dashur të jem pjesë përbërëse e një qeverie. Ju i dini qëllimet e mia, nuk kam ardhur këtu që të shtyhem për një vend në Parlament, as të luftoj për një funksion diku tjetër. Unë i kam punët mirë dhe jam president i vetvetes dhe jo i një kompanie, unë kam jetën time të lirë, kam ardhur këtu t'ia ndihmojë Kosovës. T'ia paguaj borxhin Kosovës dhe për këtë unë duhet ta respektoj atë që ma garanton suksesin tim dhe kjo vetëm nëse unë planifikoj, ekzekutoj, kontrolloj dhe e kam unifikimin e rezultateve... (VIJON).

Intervitë e kryetarit të AKR-së, z.Behgjet Pacolli, dhënë të përditshmes Epoka e Re, të datës 1 dhe 2 shkurt 2007